

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Emine Mustafa dhe Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarve B.K., për shkak të veprës penale trafikimi me njerëz nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 të KPK dhe mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, I.Z. dhe Gj.B., trafikimi me njerëz, në ndihmë nga neni 171 par. 2 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 33 të KPK, ndërsa Gj.B. dhe F.B. secili veç e veç për veprën penale shërbime seksuale të viktimës së trafikimit nga neni 231 par. 2 lidhur me par. 1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve Gj.B. dhe B.K., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë, Pm.nr.130/2016 datë 23.12.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.198/2017 datë 27.7.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 30 prill 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me miratimin e pjeshëm të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit Gj.B., ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë, Pm.nr.130/2016 datë 23.12.2016 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.198/2017 datë 27.7.2017, përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale dhe vendimin mbi dënimin, ashtu që vepra penale nga dispozitivi **I** trafikimi me njerëz në ndihmë nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 të KPK, si dhe vepra penale nga pika **III** shërbime seksuale të viktimës së trafikimit nga neni 231 par.2 lidhur me par.1 të KPK, në raport me të dënuarin Gj.B., juridikisht cilësohen si një vepër penale trafikimi me njerëz në ndihmë nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 të KPK dhe për këtë vepër e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 27.1.2016 gjer më 23.12.2016, ndërsa dënimin me gjobë në shumë prej 1.000 €, e merr si të vërtetuar.

II. Në pjesën tjetër, kërkesa e mbrojtësit të të dënuarit Gj.B., si dhe kërkesa e mbrojtësit të dënuarit B.K., të paraqitura kundër aktgjykimit të lartcekur refuzohen si të pabazuara.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë - Departamenti për të Mitur, Pm.nr.130/2016 datë 23.12.2016, të dënuarit janë shpallur fajtor dhe atë: B.K., për shkak të veprës penale trafikimi me njerëz nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 të KPK, dhe mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, I.Z. dhe Gj.B., trafikimi me njerëz, në ndihmë nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 33 të KPK, ndërsa Gj.B. dhe F.B. edhe për shkak të veprës penale secili veç e veç shërbime seksuale të viktimës së trafikimit nga neni 231 par.2 lidhur me par.1 të KPK, dhe për këto vepra i janë përcaktuar dënimet: B.K. për veprën e parë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 vite dhe dënim me gjobë 2.000 €, ndërsa për veprën e dytë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 muajsh dhe është gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 27.1.2016 gjer më 23.12.2016 dhe dënimin me gjobë në shumë prej 2.000 €, Gj.B., për veprën e parë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vite dhe me dënim me gjobë prej 1.000 €, ndërsa për veprën e dytë 2 vite dhe është gjykuare me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 10 (dhjetë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 14.3.2016 gjer më 23.12.2016 dhe dënimi me gjobë në shumë prej 1.000 €, I.Z., për veprën e parë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vite, ndërsa për veprën e dytë dënim me burgim prej 3 muajsh dhe është gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 1 (një) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 27.1.2016 gjer më 23.12.2016 dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 €, kurse F.B. me dënim me gjobë në shumë prej 3.500 €, të cilin dënim është obliguar që ta paguajë në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse dënimi me gjobë nuk paguhet nga ana e të dënuarve të njëjtat do t'u zëvendësohen me dënim me burgim. Janë detyruar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumën prej nga 100 € në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Është shqiptuar edhe dënimi plotësues konfiskimi i veturës "G..." V 1.9 TDI, ngjyrë metalike me tabela të regjistrimit ..-...-., viti i prodhimit 2..., si dhe shuma e të hollave prej 261 €. E dëmtuara Q.K., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil. Me të njëjtin aktgjykim në pajtim me dispozitën e nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPK, i pandehuri I.Z. është liruar nga akuza për shkak të veprës penale shërbime seksuale të viktimës së trafikimit nga neni 231 par.2 lidhur me par.1 të KPK.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin PAKR.nr.198/2017 datë 27.7.2017, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorit të Shtetit dhe mbrojtësve të të dënuarve, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit B.K., R.K., avokat nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe

- mbrojtësi i të dënuarit Gj.B., R.G., avokat nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që i dënuari për veprën penale të trafikimit me njerëz të lirohet nga akuza ose të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr.211/2017 e datës 8.11.2017, ka dhënë përgjigje në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim me nenin 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa konstatoi se:

Kërkesa e mbrojtësit të dënuarit Gj.B., është e bazuar vetëm për sa i përket cilësimit juridik të veprës penale, ndërsa në pjesën tjetër kjo kërkesë si dhe kërkesa e mbrojtësit të dënuarit B.K. janë të pabazuara.

Mbrojtësi i të dënuarit B.K., në kërkesën e tij pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.8 dhe 1.12 lidhur me nenin 370 par.4, 6, 7, 8 dhe 9, nenit 262 par.4 të KPPK, sepse

- aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370 të KPPK, për faktin se nuk përmban të dhënat e nevojshme të parapara nga neni 365 të KPPK, të cilën dispozitë më pas e citon për të theksuar se dispozitivi I. është i paqartë sepse me një përshkrim të veprës janë shpallur fajtor B.K., për veprën penale trafikimi me njerëz ndërsa Gj.G. dhe I.Z., për ndihmë në trafikim me njerëz;

- është shkelur dispozita e nenit 270, të cilën dispozitë e citon duke mos specifikuar se në çfarë kuptimi është shkelur kjo dispozitë por thekson se gjykata e shkallës së dytë i ka injoruar shkeljet esenciale pa dhënë ndonjë arsyetim për këtë pretendim.

Lidhur me shkelje të ligjit penal në kërkesë potencohet se për shkak të shkeljeve esenciale është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit ndërsa, asnjë gjykatë nuk ka dhënë arsye për figurën e veprës penale të trafikimit e as për ndihmë.

Mbrojtësi i të dënuarit Gj.B., thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 lidhur me nenin 370 të KPPK:

- nenit 370 par. 6 sepse në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë nuk janë dhënë arsye për çdo pikë të aktgjykimit, nuk ka arsye se cilat fakte dhe për çfarë arsye gjykata i merr të vërtetuara apo të pavërtetuara, nuk është bërë vlerësimi i provave, në veçanti atyre kundërthënëse lidhur me ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të dënuarit Gj. dhe nuk ka dhënë arsye me çfarë prova gjykata ka mbështetur konkludimin e saj lidhur me fajësinë e të dënuarit, meqë edhe vetë e dëmtuara në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ky i dënuar nuk e ka trafikuar. Po ashtu, thekson se aktgjykimi mbështetet vetëm në deklaratën e të dëmtuarës. Ndërsa sa i përket shkeljes së ligjit penal, në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit Gj., thekson se i dënuari është shpallur fajtor për dy vepra penale për veprimet e njëjta edhe pse me asnjë provë nuk është vërtetuar se i dënuari ka kryer dy vepra në veçanti veprën e trafikimit me njerëz dhe si pasojë e shkeljes së ligjit penal edhe dënimi i shqiptuar është i ashpër.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson si të pabazuara pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit B., lidhur me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale meqë mbrojtësi vetëm parafrazon dispozitat ligjore pa dhënë arsye se ku ekziston ky dimension i shkeljes së dispozitave të procedurës penale.

As pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit Gj.B. se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm, nuk është i bazuar për faktin se kjo Gjykatë vlerëson se nuk bëhet fjalë për paqartësitë në dispozitivin I. të aktgjykimit të shkallës së parë.

Qëndron fakti se në dispozitivin I. të aktgjykimit është dhënë një përshkrim faktik të veprës penale trafikimi me njerëz nga neni 171 por të gjithë të dënuarit, mirëpo, në këtë përshkrim janë specifikuar të gjitha veprimet konkrete të secilit prej të dënuarve si dhe rrethanat për ndihmën për të dënuarit Gj. dhe I. i cili përshkrim është kompatibil edhe me cilësimin juridik të veprës penale për çfarë pretendimi rezulton të jetë i pabazuar.

Nuk janë të bazuara pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve se aktgjykimeve të kundërshtuara iu mungon arsyetimi mbi faktet vendimtare. Kjo nga fakti se në të dy aktgjykimet janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe të qarta lidhur me të gjitha faktet relevante, sikurse edhe për dënimet e shqiptuara. Vlerësimi i provave është bërë në harmoni me dispozitën e nenit 361 par. 2 të KPPK.

Pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit Gj.B., se aktgjykimi bazohet vetëm në një provë respektivisht deponimin e të dëmtuarës dëshmitares Q.K., nuk është i bazuar për faktin se kjo provë nuk është e vetme dhe provë e izoluar por aktgjykimet bazohen edhe në një mori provash tjera formale dhe materiale siç janë elaboruar në arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë.

Qëndron fakti se e dëmtuara në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se i dënuari Gj. nuk e ka trafikuar, mirëpo ka ngelur e paqartë nëse e dëmtuara bazuar në shkallën e zhvillimit të saj psikologjik dhe nivelin e arsimimit, ishte në gjendje të kuptojë këtë shprehje. Megjithatë, e dëmtuara gjatë gjithë fazave të procedurës penale ishte konsekuente në deklarimin e saj lidhur me përjetimet gjatë trafikimit nga të dënuarit. Kështu, në mënyrë të qartë ajo ka pohuar se fillimisht është shantazhuar nga i dënuari B., i cili e ka kërcënuar se do t'i publikoj fotot e saj lakuriq nëse nuk del me të. Më pas, kanë filluar takimet me të dënuarin B. i cili e ka dërguar në banesën e tij në Prishtinë, ku është njoftuar me të dënuarit Gj. dhe I. Ka pohuar se ka pasur marrëdhënie seksuale me B. dhe Gj. dhe për faktin se është detyruar që të ketë marrëdhënie seksuale edhe me të dënuarin F., i cili gjatë gjithë fazave të procedurës penale, ka pranuar veprën penale si dhe faktin se i dënuari B. dhe Gj. atë e kanë dërguar në një motel në S..., që të ketë marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën Q., për çfarë ka paguar një sasi të hollash dhe atë 100 € të dënuarit B., mirëpo, më pas nga ai i dënuari B. dhe Gj., kanë kërkuar edhe të holla të tjera në emër të shërbimeve seksuale të ofruara nga e dëmtuara. Ky i dënuar, po ashtu ka deklaruar se pasi që ka pasur marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën ka kuptuar se dy të dënuarit të parë ia kishin shitur Q. me para. Deklarata e këtij të pandehuri për këto fakte relevante përputhet edhe me deklaratën e të dëmtuarës Q., prandaj vlerësimi i saj nga të dy gjykatat ka qenë në harmoni me ligjin.

Përveç këtyre deklaratave aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të cilën e ka konfirmuar edhe gjykata e shkallës së dytë bazohet edhe në provat tjera siç është paraqitur në faqen 10-14 të aktgjykimit të shkallës së parë, të cilën vlerësim e pranon edhe kjo Gjykatë.

Në mbështetje të provave të administruara, rezulton se përfundimet e të dy gjykatave lidhur me përshkrimin faktik dhe cilësimin juridik të veprës penale nga pika I të dispozitivit – trafikimi me njerëz nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 të KPK, janë të drejta dhe të ligjshme, meqë në kuadër të veprimeve konkrete të ndërmarra i dënuari B., rekrutoi dhe strehoi të dëmtuarën Q., në banesën e tij, ku qëndronin edhe dy të dënuarit të tjerë me ndihmën e të cilave arriti që të trafikoi duke detyruar të ketë marrëdhënie seksuale me të dënuarin F. dhe si kundër shpërblim, i dënuari B., ka marrë të holla në shumë prej 100 €, prandaj në këtë pjesë drejt është aplikuar ligji penal.

Mirëpo, kjo Gjykatë konstatoi se të dy gjykatat në praninë e këtyre rrethanave, gabimisht kanë aplikuar ligjin penal në raport me të dënuarin Gj.B., kur e ka shpallur fajtor edhe për veprën penale shërbime seksuale të viktimës së trafikimit nga neni 231 par.2 lidhur me par.1 të KPK, meqë si u elaborua më sipër, kjo vepër konsumohet në veprën penale të trafikimit me njerëz sepse me pa mëdyshje është vërtetuar se i dënuari Gj. ka kryer veprën penale trafikimi me njerëz në ndihmë nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 33 të KPK.

Për shkak të ricilësimit juridik të veprës penale në favor të të dënuarit, kjo Gjykatë ndryshoi vendimin mbi dënimin dhe të dënuarit Gj.B., i shqiptoi dënimin me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se në praninë e rrethanave të konstatuara nga dy gjykatat, dënimi i shqiptuar është në proporcion me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, shkallën e përgjegjësisë penale të dënuarit si dhe rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale, duke pritur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
Pml.nr.312/2017, më 30 prill 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Valdete Daka